

Dy (2) Vendime të Kuvendit të Komunës të aprovuara me 24 Dhjetor 2020;

1. Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmëria e Parcelës Kadastrale Nr. 00494-15 në ZK Kaçanik për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës “ Ismail Raka” në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 07-464/01-30640/20; dhe
2. Vendimin për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, shkollave të komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-31030/20.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01 Nr. 07-464/01-30640/20  
Kaçanik, 24.12.2020

Në bazë të nenit 12, 14 lidhur me nenin 17. 1 (a) dhe (b) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-139 - për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 52/08 Maj 2009), me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010 (Gazeta Zyrtare Nr. 91/10 Dhjetor 2010), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Propozim Vendimit 01Nr. 07-464/01-30640/20 prej datës 09.12.2020 të Kryetarit të Komunës- arsyetuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (bashkangjitur këtij vendimi), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë: 24 Dhjetor 2020, mori këtë:

#### V E N D I M

#### PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK, PARCELA KADASTRALE NR. 00494-15 ZK KAÇANIK, PËR ZGJERIMIN DHE NDËRTIMIN E RRUGËS “ ISMAIL RAKA” NË KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, Shpallet me interes të përgjithshëm publik, Parcela Kadastrale Nr. 00494-15 në ZK Kaçanik, për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës “ Ismail Raka” në Kaçanik dhe lidhur me këtë, mund të filloj procedura e shpronësimit.
2. Patundshmëria në të cilën do të zgjerohet dhe ndërtohet një pjesë e rrugës “Ismail Raka” në afërsi të Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik, është pjesë e parcelës kadastrale Nr. 00494-15, me kulturë, Arë e klasës së katërt (4), në sipërfaqe prej 253m2 ZK Kaçanik, e cila pronë evidentohet në emër të, Amer (Shaqir) Shurdhani.
3. Zgjerimi i segmentit rrugor të rrugës së sipërcekur, arsyetohet së është me interes publik, për faktin së, ndikon në lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe uljen e rrezikshmëtisë së këmbësorëve.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Certifikata e pronës me Nr. 70917048-00494-15, Kopja e Planit dhe Shkresa tjera.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
6. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme, pronën e paluajtshme të regjistroj në RDPP.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e regjistrimit të protokollit të MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohen palët dhe mekanizmat tjerë relevantë), Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli







Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government



|                                           |                                                                                                                 |                                    |
|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
| Për:                                      | Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>Kemal Mërseli, Kryesues e kuvendit të Komunës së Kaçanikut       |                                    |
| Kopje:                                    | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë             |                                    |
| Përmes:                                   | Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>Trim Berisha, Z.v, Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së |                                    |
| Nga:                                      | Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit<br>Ligjor dhe Monitorim të Komunave                                   | Datë:<br>11.01.2021<br>Nr.020-1026 |
| 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave                                                   |                                    |
| 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor    | Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave                                                          |                                    |
| Lënda:                                    | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut                                                       |                                    |
| Lloji i aktit:                            | <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës                                                           |                                    |

I nderuar Kryetar,  
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

|                                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale Nr.00494-15 ZK Kaçanik për zgjerimin dhe ndërtimin rrugës "Ismail Raka" në Kaçanik. |
| I miratuar më datë: 24.12.2020                                                                                                                                 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 30.12.2020                                                                                                          |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik  
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



Kaçanik  
09.12.2020

Në mbështetje të nenit 58, shkronja h) e Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit bënë këtë:

**PROPOZIM**

Në bazë të nenit 4 të ,paragrafi 2.4, të Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtëshme Ligji 03/L-139 ,nenit 6 paragrafi 2 shkronja f ) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës të merr këtë:

**VENDIM**

**PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK, PARCELA KADASTRALE NR 00494-15 Z.K KAÇANIK PËR ZGJERIMIN DHE NDËRTIMIN E RRUGËS " ISMAIL RAKA" NË KAÇANIK.**

**I**

VËRTETOHET se zgjerimi-ndërtimi pjesës së rrugës " Ismail Raka" në afërsi të Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik është në interes të përgjithshëm publik dhe mund të filloj procedura e shpronësimit.

Patundshmëria në të cilën duhet të zgjerohet-ndërtohet rruga është pjesë e parces kadastrale nr.00494-15 ,me kulturë arë e klasës 4 ,me sipërfaqe prej 253 m2, Z.K Kaçanik e cila evidentohet në emër të Amer Shaqir Shurdhani

**II**

Për zbatimin e këtij Vendimi do te kujdeset; Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**III**

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.

**Arsyetim**

- Në kërkesën nr; 07-464/01-30640/20 nga DSHPE thuhet arsyet e nevojshme për zgjerimin këtij segmenti rrugorë, ku do të ndikojë në lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe uljen e rrezikshmërisë së këmbësorëve që lëvizin nëpër këtë segment rrugorë.

- DUKMM duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke e marr parasysh Interesin Publik për realizimin e projektit për zgjerimin –ndërtimin e pjesës së rrugës " Ismail Raka" në afërsi të Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik e e cila ka karakter të interesit publik dhe pas miratimit të këtij Propozim Vendimi nga ana e Kuvendit të Komunës do të fillojmë me procedurat e Shpronësimit për pasurinë e palujtëshme të theksuar më lartë.



Drejtori  
Ukshin Qallaku



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00494-15

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunalne / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Kaçanik / Kaçanik / Kaçanik

Certificate draft

09.12.2020 - 09:53

Kaçanik / Kaçanik / Kaçanik

KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

Kaçanik / Kaçanik / Kaçanik

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësise kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësise<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                      | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-70917048-00494-15                                                       | PARCELË / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shoqërore /<br>Društvena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Urban                     | 1070                                                | 1-2017                           | 06.02.2017                                        |                                  |

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojednostoi adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| ARA E SHURDHANIT/ARA E SHURDHANIT/ARA E SHURDHANIT                 |                                             | ARA E SHURDHANIT                                             | 06.02.2017                                        |                                  |



## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina<br>Area |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| 1                       | Bujqësore/Poljoiprivredno/Agriculture                                              | Atrat/Njive/Arable                                                                 | Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land    | 1070                                |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                                               | Emri<br>Ime<br>Name        | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|
| Pronësi individuale (Një<br>Pronarë) / Individualno<br>Vlasništvo (1 VL.) / single<br>owner | SHURDHANI AMER<br>(SHAQIR) | 1001149241                            | KAÇANIK / KAÇANIK /<br>KAÇANIK /       |                                             |                                                             | 1/1                                          |                                   | 06.02.2017                       |



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosova

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostorog  
Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Kaçanik

Zona kadastrale / Katastarska zona: Kaçanik


Lloji i njësise kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcele

Nr. i njësise kadastrale / Br. katastarske jedinice: 494-15

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Shkalla e zrygimit / Razmera plana 1: 500

| Nr. | Y            | X            | H        | Kodi | Përkthimi           |
|-----|--------------|--------------|----------|------|---------------------|
| 1   | 7521107.6940 | 4677404.8086 | 520.9798 | 3    | Muri                |
| 2   | 7521122.0728 | 4677405.5674 | 521.2324 | 2    | Kunj metalik        |
| 3   | 7521135.8021 | 4677406.3946 | 521.6697 | 2    | Kunj metalik        |
| 4   | 7521124.0772 | 4677429.7411 | 520.9895 | 2    | Kunj metalik        |
| 5   | 7521140.9072 | 4677406.8811 | 522.1521 | 2    | Kunj metalik        |
| 6   | 7521145.0700 | 4677407.2780 | 0        | -    | Pikë e konstruktuar |
| 7   | 7521104.723  | 4677391.467  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 8   | 7521108.32   | 4677407.635  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 9   | 7521109.68   | 4677414.646  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 10  | 7521110.754  | 4677421.273  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 11  | 7521111.597  | 4677428.979  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 12  | 7521139.996  | 4677430.731  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 13  | 7521140.726  | 4677429.291  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 14  | 7521145.495  | 4677414.741  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 15  | 7521145.625  | 4677413.461  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 16  | 7521147.365  | 4677408.261  | 0        | -    | Pikë vektor         |
| 17  | 7521127.315  | 4677399.672  | 0        | -    | Pikë vektor         |



Rilevoi / Snimio: Visar Mulaku

(emri dhe mbiemri i gjeneralit/kompanisë dhe i prezantuesit të kompanisë)

Nënskikimi / Polpisi: \_\_\_\_\_

Data e rilevimit / Datum snimanja: \_\_\_\_\_

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar dhe i prezantuesit të kompanisë)

Nënskikimi / Polpisi: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_

ZYRA KOMUNALE KADASTRALE  
OPŠTINSKA KATASTARSKA KANCELARIJA  
MUNICIPALITIS CADASTRAL OFFICE

Komuna Kaçanik

Ndarje fizike e parcelës kadastrale  
494-15

ZONA KADASTRALE  
KATASTARSKA ZONA  
CADASTRAL ZONE

Kaçanik

**REGJISTRI I FLETËPARAQITJEVE**  
**SPISAK PRIJAVA**  
**REGISTER OF APPLICATIONS**



GJENDJA E RE == NOVO STANJE == NEW SITUATION

[illegible]

# STUDIMI

Mbi ndarjen e parcelave 494-15  
Kaçanik

Nënshkrimi



## Ndarja e Parcelave

|    |                                                                                                          |                                                                                                       |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | Emri dhe numri i zonës kadastrale                                                                        | Kaçanik -70917048                                                                                     |
| 2  | Emri i pronarit apo shfrytëzuesit,                                                                       | Amer (Shaqir) Shurdhani                                                                               |
| 3  | Adresa                                                                                                   | Kaçanik                                                                                               |
| 4  | Numri i Certifikatës së pronës (fletëposedim),                                                           |                                                                                                       |
| 5  | Numri i parcelës                                                                                         | P-70917048-00494-15                                                                                   |
| 6  | Sipërfaqja e parcelës                                                                                    | 1070 m <sup>2</sup>                                                                                   |
| 7  | Shfrytëzimi aktual                                                                                       | Arë (4)                                                                                               |
| 10 | Forma grafike(kopja e planit)                                                                            | Manuali në shtojcë                                                                                    |
| 11 | Pershkrimi i njësisë                                                                                     | Njësitë janë formuara me ndarje fizike                                                                |
| 12 | Koordinatat e pikave të kufirit në sistemin zyrtar Kosovaref 01                                          | Janë të përshkruara në skicën e matjes nga vendi i ngjarjes (manual) si dhe në listën e koordinatave. |
| 13 | Karakteristikat themelore të parcelës (mënyra e formimit të parcelës, me rindërtim ose me nëndarje etj.) | Nga parcela 494-15 formohen parcelat e reja kadastrale 494-16 dhe 494-17.                             |
| 14 | Data e hartimit                                                                                          | 26.02.2020                                                                                            |
| 15 | Emri i personit zyrtar (gjeodetit)                                                                       | Visar Mulaku                                                                                          |

| Nr. | Y            | X            | H        | Kodi | Përshkrimi          |
|-----|--------------|--------------|----------|------|---------------------|
| 1   | 7521107.6940 | 4677404.8086 | 520.9798 | 3    | Muri                |
| 2   | 7521122.0728 | 4677405.5674 | 521.2324 | 2    | Kunj metalik        |
| 3   | 7521135.8021 | 4677406.3946 | 521.6697 | 2    | Kunj metalik        |
| 4   | 7521124.0772 | 4677429.7411 | 520.9895 | 2    | Kunj metalik        |
| 5   | 7521140.9072 | 4677406.8811 | 522.1521 | 2    | Kunj metalik        |
| 6   | 7521145.0700 | 4677407.2780 | 0        | -    | Pikë e konstruktuar |
| 7   | 7521104.723  | 4677391.467  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 8   | 7521108.32   | 4677407.635  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 9   | 7521109.68   | 4677414.646  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 10  | 7521110.754  | 4677421.273  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 11  | 7521111.597  | 4677428.979  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 12  | 7521139.996  | 4677430.731  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 13  | 7521140.726  | 4677429.291  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 14  | 7521145.495  | 4677414.741  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 15  | 7521145.625  | 4677413.461  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 16  | 7521147.365  | 4677408.261  | 0        | -    | Pikë vektori        |
| 17  | 7521127.315  | 4677399.672  | 0        | -    | Pikë vektori        |





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01 Nr. 104/02-31030/20  
Kaçanik, 24.12.2020

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse-dru për ngrohje me masën drusore të konfiskuar në vitin 2020, të Propozim Vendimit të DBPZHR, 01 Nr. 104/02-31030/220 prej datës 15.12.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 24 Dhjetor 2020, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR NË VITIN 2020,**  
**SHKOLLAVE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuar në vitin 2020, 116.19 metër kub (m<sup>3</sup>) apo shprehur në metër hapësinore 166.15 (mh) e cila masë drusore ndodhet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, pjesa që i takojnë komunës, t'iu ndahen atyre shkollave të komunës, të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masën drusore.
2. Obligohet drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjendet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës t'i identifikoj shkollat të cilat kanë nevojë për masë drusore dhe të caktoj sasinë për secilën shkollë në bazë të nevojës.
4. Arsyetimi i ndarjes së masës drusore është dhënë nga DBPZHR në Propozim Vendimin dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë, si dhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
3. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës; dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës**  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

01-104/02-31030/20  
**Kaçanik**

Bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës me qëllim të furnizimit të shkollave me lëndë djegëse – dru për ngrohje, Kryetari i Komunës së Kaçanikut:

## **PROPOZON**

Që Kuvendi i Komunës së Kaçanikut lidhur me masën drusore të konfiskuar për vitin 2020, në mbledhjen e radhës të tij të datës \_\_\_\_\_ të merr këtë të merr:

## **V E N D I M**

### **PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR GJATË VITIT 2020, SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

#### **I.**

Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2020, që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, atyre shkollave të Komunës së Kaçanikut të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masën drusore.

#### **II.**

Obligohet DBZHRP-së që të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjenden në Autoparkun e Shoqatës Invalidëve të Luftës.

#### **III.**

Obligohet Drejtoria për Arsim dhe Kulturë ti identifikojë shkollat të cilat kanë nevojë për masë drusore dhe të caktojë sasisë për secilën shkollë në bazë të nevojës.



#### IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

#### V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

### Arsyetim

Duke pas parasysh kërkesat e mëdha të shkollave për masë drusore për ngrohje, shpenzimet e larta që po krijohen me rastin e blerjes së masës drusore për furnizim të shkollave si dhe nevojës për kursim të buxhetit të Komunës, propozoj që të vendoset si në dispozitiv të këtij Propozim-Vendimi, për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, 116.19 metër kub (m<sup>3</sup>) apo shprehur në metër hapsinor 166.15(mh), sipas kontratës numër 01-104/02-24064 të datës 01.07.2017, të lidhur për ndarjen e masës drusore të konfiskuara ndërmjet Komunës dhe Shoqatës, në raport 50-50%, për shërbimet e ofruara nga ana e SHIL-ës (transporti i masës drusore gjatë konfiskimit, deponimi dhe ruajtja e masës drusore).

**Kryetari i Komunës**

